



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**P/VENDIM**

Nr. 661 / Datë 18.01 .2021

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË TË PASTREHËVE QË PËRFITOJNË  
SUBVENCIONIM TË QIRASË PËR VITIN 2021”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr.362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”. Pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë:

**PËR TË VENDOSUR:**

1. Të miratojë listen e të pastrehëve që përfitojnë subvencionim të qirasë për vitin 2021, sipas shtoitës A me numër rendor 55 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Në zbatim të këtij Vendimi, Bashkia Lezhë t’i paraqesë kërkesën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për financimin e subvencionimit të qirasë nga buxheti i shtetit, me afat kohor 1 vjeçar.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**

